



15 PRILL 2016

ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË SERBISË DHE IMPAKTI I TYRE NË SKENËN POLITIKE SERBE NË KOSOVË

Më 4 mars, Kryetari i Serbisë i shpalli zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare pas shpërbërjes së parlamentit serb më herët. Institucionet serbe paralajmëruan që këto zgjedhje do të organizoheshin edhe në Kosovë gjithashtu. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka marrë ndonjë vendim të veçantë në këtë drejtim dhe kryeministri Isa Mustafa deklaroi se nuk do të ketë zgjedhje klasike në Kosovë. Në vend të zgjedhjeve, deklaroi ai, do të ketë grumbullim të votave me lehtësim nga ana e misionit të OSBE-së në Kosovë, të cilën misioni i OSBE-së ende nuk e ka konfirmuar. Ai poashtu deklaroi se votimi është e drejtë e qytetarëve serb të Kosovës, të cilët e gëzojnë të drejtën e dyshtetësisë sipas kushtetutës dhe ligjeve në fuqi.¹

Edhe pse ekziston një paqartësi se si do të organizohen në Kosovë zgjedhjet e paralajmëruara nga Serbia, fushata për këto zgjedhje është duke u zhvilluar me gjallëri të plotë. Një fushatë intensive është duke u organizuar për të tërhequr votuesit në Kosovë. Kryeministri në detyrë i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, së fundmi vizitoi disa komuna në pjesën veriore të Kosovës ku ai zhvilloi takime të fushatës për vehten dhe partinë të cilën e udhëheq ai, Partia progresiste serbe (SNS). Gati menjëherë pas tij, ministri në detyrë i punëve të jashtme të Serbisë, Ivica Dačić, poashtu vizitoi Kosovën. Ai e përshkroi vizitën si “vizitë në tempujt e kulturës”, po megjithatë e shfrytëzoi rastin për të bërë fushatë dhe kërkuar votën e qytetarëve.² Parti tjera politika gjithashtu kanë bërë fushatë dhe organizuar takime me votues. Në vijim japim një përditësim të zgjedhjeve parlamentare të Serbisë dhe zhvillimeve në lidhje me organizimin e paralajmëruar të tyre në Kosovë si dhe implikimet e mundshme që këto zgjedhje mund të kenë për jetën politike të komunitetit serb në Kosovë dhe në zhvillimet politike në Kosovë në përgjithësi.

Prapaskena

Më 24 prill, Serbia organizon zgjedhje parlamentare, regjionale, dhe lokale. Zgjedhjet parlamentare do të mbahen edhe në Kosovë, në vendet ku jetojnë serbët. Duke u bazuar në raporte të qeverisë së Serbisë, zgjedhjet lokale nuk do të mbahen në Kosovë. Qeveria e Kosovës ende nuk ka dhënë ndonjë deklaratë zyrtare publike për këtë çështje, duke deklaruar vetëm se “nuk është marrë ndonjë vendim ende” dhe se “Kosova do të veprojë në pajtim me praktikën më

¹ <http://www.gazetaexpress.com/lajme/vendvotimet-e-serbise-ne-kosove-mustafa-i-quan-qendra-te-grumbullimit-188191/>

² <http://www.oranews.tv/rajoni/dacic-neser-viziton-trashegimine-kulturore-serbe-ne-kosove/>

të mira ndërkombëtare”.³ Mediat në Kosovë kanë ngritur mundësinë që OSBE-ja do të lehtësojë këto zgjedhje ngajshëm me lehtësimin e saj gjatë zgjedhjeve të organizuara nga Kosova në komunat veriore, dhe kryeministri Mustafa e konfirmoi këtë kur deklaroi se OSBE-ja do të lehtësojë mbledhjen e votave të hedhura gjatë zgjedhjeve.⁴ Si pjesë e fushatës parazgjedhore, kryeministri në detyrë i Serbisë Aleksandar Vuçiq vizitoi Kosovën më 3 prill dhe zhvilloi fushatë për partinë e tij. Gjatë vizitës, Vuçiq deklaroi se SNS-ja do t’i fitonte këto zgjedhje, duke përfshirë në Kosovë, dhe se ai ishte në Kosovë për të “mbështetur popullin i cili po përjeton kohë të vështira”.⁵ Kryeministri Mustafa deklaroi se vizita e Vuçiqit “nuk paraqet problem meqë ai ka kërkuar leje dhe ne ia kemi dhënë atë”.⁶

Bazuar në intervista të targetuara të ECMI Kosovës dhe takime në terren, ekziston një ndienjë e përgjithshme në mesin e popullatë serbe në Kosovë se ata dëshirojnë të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare të Serbisë në numër të konsiderueshëm. Kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht se ata mbështesin qeverinë e tanishme serbe apo politikën e saj në relacion me Kosovën. Akti i votimit, shumë nga bashkëbiseduesit tanë thanë, e ka një peshë të madhe simbolike për serbët e Kosovës sepse ia mundëson atyre ushtrimin e të drejtave të tyre si shtetas edhe të Serbisë, duke konfirmuar kështu edhe marrëdhënien e tyre me shtetin e Serbisë. Në këtë drejtim, pyetja se për kë do të votojnë ka peshë më të vogël në krahasim me nevojën e tyre për të marrë pjesë në zgjedhje.

Dominimi në rritje i SNS-së në skenën politike të serbëve të Kosovës

Në prag të zgjedhjeve, SNS ka vendosur kontrollë të paparë deri tani mbi jetën politike të serbëve në Kosovë. Fushata e SNS-se është e koordinuar dhe mbështetur me logjistikë nga Zyra e Qeverisë së Serbisë për Kosovën. Udhëheqësi i zyrës dhe një nga zyrtarët udhëheqës të SNS-së, është duke bërë fushatë të fuqishme në Kosovë. Vija ndarëse mes tij si shërbyes civil dhe zyrtar i partisë SNS nuk ekziston. Shpeshherë Gjuriq rikonfirmon angazhimin e qeverisë së tanishme serbe të dominuar nga SNS me popullatë serbe në Kosovë, posaçërisht nëpërmjet Dialogue të Brukselit. Shpesh argumentohet se politikat e SNS-së për të rregulluar shërbimet publike të ofruara nga Serbia për popullatën serbe më Kosovë nëpërmjet Dialogut të Brukselit po sjellin përmirësime konkrete në jetën e komunitetin serb të Kosovës.

Ka fare pak ose aspak hapësire për pluralitet politik në debat. Mbështetja e shtetit të Serbisë për popullatën serbe në Kosovë shkon përmes Zyres për Kosovën dhe barazohet totalisht me kontributin e SNS-ë. Çfarë do opozite apo shenje e ndarjes politike delegitimizohet si kërcënuese për interesat e Serbisë në Kosovë. Ekzistojnë, poashtu, thashetheme se qeveria e Serbisë bën presion tek shërbyesit civil në Kosovë (të punësuar në institucionet paralele serbe) që të mbështesin SNS-në duke siguruar vota për të ose duke siguruar që një numër i mjaftueshëm i votuesve merr pjesë nëpër takime të fushatës.

³ <http://botasot.info/lajme/522589/qeveria-ende-pa-vendim-per-mbajtjen-e-zgjedhjeve-te-serbise-ne-kosove/>

⁴ <http://www.gazetaexpress.com/lajme/vendvotimet-e-serbise-ne-kosove-mustafa-i-quan-qendra-te-grumbullimit-188191/>

⁵ <http://politiko.net/vucic-ne-kosove/>

⁶ <http://fax.al/read/news/3281750/11424510/mustafa-vucic-ne-kosove-nuk-paraqet-problem-i-kemi-dhene-leje-per-kete>

SNS-ja ka arritur që të sigurojë mbështetjen e një shumice të madhe të politikanëve serbë që janë pushtetarë në Kosovë. Në nivelin qendror, të gjithë ministrat serbë në qeverinë e Kosovë janë ose anëtarë të SNS-ë, ose kanë shprehur përkrahjen e tyre për politikën e partisë. Ata rregullisht i bashkangjiten Gjuriqit gjatë vizitave të tij në Kosovë. Politikanët serbë të Kosovës në nivelin lokal i janë bashkangjitur SNS-ë në mënyrë masovike gjatë tubimeve politike në Shtërpcë, Zubin Potok dhe regjionin e Anamoravës.⁷ Kryetarët e komunave të Zubin Potokut dhe Novobrdës, Stevan Vulović and Svetislav Ivanović, respektivisht, duket se kanë braktisur Partinë Socialiste të Serbisë (SPS) të ministrit të tanishëm të punëve të jashtme Daçiç dhe kanë kaluar në SNS. I vetmi politikan serb i Kosovës i cili është në fuqi dhe nuk është anëtar i SNS-në është Dragan Jabllanović, kryetar i komunës së Leposaviqit, i ndërlidhur me Lëvizjen Socialiste të Aleksandar Vulinit. Anëtarë tjerë të dalluar të Lëvizjes Socialiste të Vulinit janë Aleksandar Jabllanović (ish-ministër në qeverinë e Kosovës), dhe Slavsko Simić, kryetar i Listës serbe. Në lidhje me Kosovën, Lëvizja Socialiste mbështet vazhdimësinë e politikës së tanishme serbe dhe nuk bën opozitë kritike ndaj SNS-së, me të cilën Lëvizja Socialiste ka marrëveshje koalicioni në Serbi.

Nga opozita, koalicioni mes Partisë demokratike të Serbisë (DSS) dhe Dveri, si dhe Partisë radikale serbe (SRS), është koalicioni më aktiv në Kosovë. SRS-ja e Vojislav Sheshelit mbajti një tubim elektorale në Mitrovicë më 12 prill. Shesheli, i shpallur *persona non grata* në Kosovë, paralajmëroi se ai personalisht do të ishte prezent në takim—me masa drastike të sigurisë—por në fund ai adresoi publikun me anë të video-linkut nga Beogradi. Mesazhi i SRS-ë është mbështetja e komunitetit serb për të qëndruar në Kosovë dhe deklarën se vetëm kthimi i plotë dhe i pakushtëzuar i Serbisë në Kosovë është zgjidhje e drejtë. Politika e qeverisë së tanishme serbe kritikohet si mashtruese, meqë po shpie tek integrimi gradual i institucioneve të Serbisë në kornizën e Kosovës.⁸

Një argument i njejtë parashtrohet nga koalicioni djathtist DSS-Dveri. Politika e SNS-së dhe e qeverisë së Serbisë drejt integritit të institucioneve të Serbisë në kornizën e Kosovës nëpërmjet Dialogut të Brukselit është vetëm hapi i parë drejt shpartallimit të plotë të të gjitha institucioneve dhe shërbimeve publike të Serbisë në Kosovë.⁹

Organizimi aktual i jetës politike të serbëve në Kosovë

Njëtrajshmëria në rritje e jetës politike të komunitetit serb në Kosovë dhe lidhja e saj e afërt me qeverinë e Serbisë është një vazhdimësi e zhvillimeve që kanë filluar me zgjedhje lokale të Kosovës të vitit 2013 dhe atyre të përgjithshme të vitit 2014, zgjedhje në të cilat elektorati serb i Kosovës votoi për një koalicion lokal të politikanëve serb të Kosovës të cilët morrën mbështetjen e qeverisë në Beograd. Lista serbe, iniciativë politike që fitoi shumicën e votave të komunitetit serb në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014, në fakt është konglomerat i politikanëve serb të Kosovës të përkatësive të ndryshme që i bashkuan forcat në mënyrë që të bashkojnë dhe fuqizojnë pozitën e politikanëve serb në nivelin qendror dhe atë lokal. Si rezultat

⁷ <http://kossev.info/strana/arhiva/djuric/6967>,
http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=09&dd=14&nav_category=11&nav_id=1039277,

http://kossev.info/strana/arhiva/djuric_kolektivno_uclanjenje_u_sns_u_kosovskom_pomoravlju/7463.

⁸ <http://kossev.info/strana/arhiva/srs/8416>.

⁹ <http://kossev.info/strana/arhiva/dss/8201>.

i këtij zhvillimi, 9 nga 10 komunat me shumicë serbe qeverisen nga kryetarë komunash që përfaqësojnë Listën serbe dhe 9 dhe 10 deputetët e komunitetit serb vijnë nga Lista serbe.¹⁰

Zhvillimet aktuale që dërgojnë tek zgjedhjet serbe të prillit 2016 tregojnë se politikanët serbë të Kosovës e kanë lidhur fatin e tyre, në mënyrë të vendosur, me SNS-në. Në fakt, edhe një kryetar i cili nuk vjen nga radhët e Listës Serbe, Bratislav Nikoliq nga Shtërpce, që është anëtarë i Partisë Liberale Serbe (SLS), parti politike që tradicionalisht merr një qëndrim më të pavarur nga Beogradi, është bashkuar me SNS-në.¹¹

Prej vitit 2013, jeta politike serbe në Kosovë ka qenë e dominuar nga Lista Serbe, një iniciativë qytetare e përbërë nga disa parti më të vogla, duke përfshirë, partinë që më herët ka qenë dominuese në skenën politike, Partinë Liberale Serbe (SLS), të kryesuar nga anëtarë i ish-kabinetit Slobodan Petroviq. Lista serbe është aktualisht pjesë e koalicionit qeverisës në Kosovë, dhe zë disa poste udhëheqëse në qeveri, duke përfshirë atë të zëvendëskryeministrit, por ndryshe nga partnerët e mëparshëm të koalicionit që kanë përfaqësuar komunitetin serb në Kosovë, ka mbajtur një qëndrim të palëkundur pro-Beogradit në të gjitha aktivitetet e saj. Përfaqësuesit e saj, duke përfshirë edhe politikanë të nivelit të lartë, udhëtojnë rregullisht në Beograd për tu takuar me politikanë të rangut të lartë atje; Mesazhet që ata marrin në Beograd pastaj në përgjithësi përcillen tek qytetarët që u përkasin komunitetit serb në Kosovë.

Në rast se SNS-ja fiton zgjedhjet parlamentare serbe, siç edhe në përgjithësi pritet, jeta politike e serbëve të Kosovës do të lidhet ngushtë me partinë në pushtet në Republikën e Serbisë. Kjo jo vetëm që do të thotë se politikanët serbë, aktualisht në qeveri, do të mbështesin qëndrimin e Beogradit në dialogun e Brukselit, siç ka qenë rasti deri më sot, por kjo, për më tepër, mund të dobësojë edhe më shumë pluralizmin politik brenda-përbrenda komunitetit serb të Kosovës. Partitë politike të serbëve të Kosovës nuk do të marrin pjesë në mënyrë të pavarur në zgjedhjet parlamentare në Republikën e Serbisë, duke zgjedhur që të garojnë si pjesë e listave të koalicioneve apo partive ekzistuese atje, të tilla si SNS, SPS, apo DSS. Kjo, nga ana tjetër, do të thotë se partitë siç janë Lista Serbe, SLS, dhe parti të tjera në Kosovë janë të lidhura ngushtë me partitë në Serbi dhe kanë tendencë të pasqyrojnë ideologjinë e partnerëve të tyre më të mëdhenj në Serbi.

Përderisa SNS-ja është partia më e madhe në Serbi dhe pritet që të fitojë zgjedhjet që do të organizohen atje, dhe të fitojë shumicën e votave në Kosovë, partitë e tjera, në koalicion me SNS-në në nivel qendror, janë gjithashtu në garë për të fituar vota në Kosovë, duke përfshirë SPS-në e Ministrit të punëve të jashtme Ivica Daçiq, dhe PS-së së Ministrit të punës, Aleksandar Vulin. Partitë aktualisht opozitare në Serbi, DS-ë dhe DSS-ë gjithashtu kanë në listat e tyre kandidatët nga Kosova dhe janë në garë për të fituar vota, edhe pse në një nivel më të ulët se SNS-ja. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të mbajtura në Serbi në vitin 2014, janë zgjedhur gjashtë – (6) deputetë që kanë përfaqësuar rajone të banuara me serbë në Kosovë. Dy nga SNS-ja, dy nga SPS-ja, një nga SDS-ja, dhe një nga PS-ja. Është interesant fakti, se kryetari aktual i

¹⁰ ECMI Kosova, 'Zgjedhjet lokale 2013: Mësimet e nxjerra për komunitetet pakicë' (19 dhjetor 2013, Anglisht); ECMI Kosova, 'Partitë politike të minoriteteve në mjedisin politik në ndryshim e sipër në Kosovë: Zgjedhjet e përgjithshme të qershorit 2014 dhe rrjedhojat e tyre' (29 qershor 2014).

¹¹ http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=09&dd=16&nav_id=1039892.

Graçanicës, Vladeta Kostiq, u zgjodh deputet në parlamentin e Serbisë në zgjedhjet e 2014; ai më pas dha dorëheqje në mënyrë që të kandidojë për kryetar të Graçanicës; zgjedhje të cilat ai i fitoi.

Centralizimi qartazi i suksesshëm i vendimmarrjes në Kosovë, -- në nivel lokal dhe qendror, i arrirë përmes ministrave të qeverisë besnik ndaj SNS-së -- do të lidhë fatin e politikanëve serbë të Kosovës me atë të SNS-së dhe liderit të saj Aleksandar Vuçiq, mund të ulë, për më tepër, llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë e këtyre politikanëve ndaj qytetarëve dhe votuesve të tyre në Kosovë.

Së fundi, mbështetja e drejtpërdrejtë, e hapur dhe e fortë e politikanëve serbë të Kosovës të rreshtuar në Listën serbe, edhe e zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës, duke përfshirë edhe ministrat dhe funksionarët tjerë të kësaj liste, për SNS-në dhe Serbinë në këtë pikë është duke u injoruar nga dy partnerët shqiptarë të koalicionit në Qeverinë e Kosovës, PDK dhe LDK. Që nga dorëheqja e Jabllanoviqit në shkurt të viti 2015, ministrat nga Lista serbe kanë qenë të prirë, në masë të madhe, për të shmangur dhënien e deklaratave të forta mbështetjeje për Serbinë, apo ato që nuk i njohin apo përligjin institucionet e Republikës së Kosovës, megjithatë, kanë mbështetur dhe kanë qenë të pranishëm në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Qeveria Serbe në Kosovë, dy partnerët shqiptarë të koalicionit, nga ana tjetër, kanë zgjedhur të injorojnë deklaratat, herë pas here, të diskutueshme dhe mbledhjet e anëtarëve të Listës serbe dhe udhëtimet e shpeshta të politikanëve serbë të rreshtuar te kjo listë në Beograd për t'u konsultuar me institucionet serbe.

Megjithatë, partitë opozitare shqiptare në Kosovë shpesh kanë marrë parasysh këtë dhe kanë dhënë mendimet e tyre. Gjatë një seance parlamentare në shkurt 2016, një deputet i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismail Kurteshi, i ka bërë pyetje përfaqësuesve të qeverisë se kush është shefi i vërtetë i ministrave të kabinetit të Kosovës nga Lista serbe. Lëvizja Vetëvendosje ka akuzuar vazhdimisht Listën serbe se është një mjet i përdorur nga Serbia për të ndarë Kosovën.¹² Partitë e tjera opozitare, kryesisht AAK dhe Nisma, kanë qenë të prira të jenë më të kujdesshme dhe kanë përqendruar kritikën e tyre mbi çështje të veçanta të tilla si Asociacioni/ Bashkësia e Komunave me shumicë Serbe dhe jo drejtpërdrejtë tek Lista serbe.¹³

¹²<http://www.telegrafi.com/vetevendosje-lista-serbe-kthehet-per-ta-ndare-kosoven/>

¹³<http://koha.net/?id=27&l=79461>

Raporte dhe analiza politike të tjera të realizuara nga ECMI Kosova:

[Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe](#)

28 janar, 2016

[Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe: obligim apo mundësi e mirë?](#)

17 dhjetor, 2015

[Incidente të përsëritura në Gorazhdec: nevoja për të vepruar shpejtë](#)

10 dhjetor 2015

[Komunitetet pakicë në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës: A ka abuzime me sistemin e kuotave?](#)

15 tetor, 2015

[Për një diskutim gjithëpërfshirës mbi asociacionin e komunave me shumicë serbe](#)

8 tetor, 2015

[Marrëveshja e re mbi asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe: hap i rëndësishëm përpara, por jo fjala e fundit](#)

7 shtator, 2015

[Mosmarrëveshjet lidhur me përdorimin e gjuhëve në Kosovë si dhe implementimi i dobët i kornizës ligjore](#)

2 gusht, 2015

[Hyn në fuqi pakoja e ligjeve për të drejtat e njeriut](#)

26 korrik, 2015

[Mbi trendin shqetësues të incidenteve të drejtuara ndaj komitetit serb në regionin e Pejës dhe Klinës](#)

19 korrik, 2015

[Vivodani: Mungesa e lajmeve është lajm i mirë](#)

2 korrik, 2015

[Dita memoriale e goranëve më 6 maj: Një mundësi e humbur për institucionet e Kosovës](#)

14 maj, 2015

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Çfarë është e \(pa\)mundur në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës?](#)

16 prill, 2015

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Një klub ekskluziv I bazuar në përkatësinë etnike?](#)

31 mars, 2015

*Nëpërmjet **Kosovo Communities Issues Monitor**, (Monitoruesit të Çështjeve të Komuniteteve të Kosovës) ECMI Kosova monitoron, analizon dhe ofron rekomandime mbi zhvillimet dhe shqetësimet që ndërlidhen me pozicionin e komuniteteve pakicë në Kosovë, brenda kornizës së legjisllacionit ndërkombëtar dhe vendor mbi të drejtat e pakicave. Analizat e paraqitura në Monitorues janë të mbështetura në monitorimin e rregullt dhe të ngushtë të medieve dhe intervistave me palë përkatëse të interesit. Në ndërkohë që ECMI Kosova përpiqet në çdo kohë që të sigurojë informacion të saktë dhe të nuancuar për të prezantuar pikëpamjet dhe perceptimet e të gjitha palëve, objektivi apo synimi i Monitoruesit nuk është që të sigurojë mbulim gazetaresk apo paraqitje faktike, por të ofrojë një element shtesë analitikë të debatit, duke reflektuar përvojën afatgjate të ECMI Kosovës mbi çështjet që kanë të bëjnë me komunitete pakicë në Republikën e Kosovës dhe kuadrin ekzistues ligjor të Kosovës dhe atë ndërkombëtar.*